



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Programi
Gratë,
Paqja dhe
Siguria

SFIDAT DHE REAGIMET INSTITUCIONALE NDAJ SIGURISË SË GRAVE SERBE TË KOSOVËS



Autore: **Milica Živić**

Është gazetare, e diplomuar në Gazetari dhe Produksion Mediatik në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit në Beograd, Serbi. Ajo mban titullin Master në Studimet Ndërdisciplinore Evropiane nga Kolegji i Evropës në Natolin, Poloni, të cilin e ndoqi me bursë të plotë për gazetari të dhënë nga Komisioni Evropian. Ajo ka qenë e angazhuar për tre muaj si praktikante dhe asistente hulumtuese në QKSS.

Redaktuar nga: **Adelina Hasani**

RRETH PROGRAMIT GJINIA, PAQJA DHE SIGURIA

Programi Gjinia, Paqja dhe Siguria është zhvilluar për të mbështetur progresin e Kosovës në arritjen e objektivave të përcaktuara në agjendën e Gruas, Paqes dhe Sigurisë. Në përputhje me Rezolutën 1325, Programi Gjinia dhe Siguria i QKSS-së synon të mbështesë institucionet e sigurisë publike në Kosovë në krijimin e politikave të përgjegjshme gjinore të brendshme dhe të jashtme. Ndër të tjera, programi synon të sigurojë pjesëmarrje të barabartë gjinore në institucionet kryesore të sigurisë së Kosovës si Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policia e Kosovës (PK). Për më tepër, ai synon të konsolidojë një gjerësi të hulumtimit që identifikon sfidat kryesore që lidhen me reformën e sigurisë në aspektin gjinor në Kosovë. Përmes ofrimit të analizave gjinore për zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë, programi i QKSS-së për e gjinisë dhe sigurisë synon të promovojë reformën e brendshme në përputhje me parimet e barazisë gjinore të vendit të përcaktuara në Ligjin për Barazi Gjinore. Programi do të zhvillohet më tej përmes:

- Avokimit qendror dhe lokal për të identifikuar sfidat kryesore që lidhen me pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë;
- Monitorimit fillestar, i mesëm dhe i fundit i rekrutimit brenda institucioneve të sigurisë publike në Kosovë
- Analizave gjinore në përputhje me objektivat e WPS të Kosovës.

Për më shumë informacione, na kontaktoni në vegzën e mëposhtme:

GenderProgram@qkss.org

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	1
GJENDJA AKTUALE E RAPORTIMIT NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE	2
Rëndësia praktike e përfshirjes e më shumë grave në sektorin e sigurisë	3
Interesi i vajzave për të iu bashkangjitur Akademisë Policore	4
REKOMANDIMET	6

HYRJE

Ky hulumtim analizon perspektivat e grave dhe vajzave të komunitetit serb në Kosovë për sigurinë e tyre, reagimin institucional ndaj dhunës në bazë gjinore dhe barazinë gjinore brenda policisë dhe sektorit më të gjerë të sigurisë.

Shumica e të mbijetuarve të dhunës në bazë gjinore, veçanërisht gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë në familje nga grupe të ndryshme etnike, përballen me mungesën e mbështetjes së qëndrueshme në nivel institucional. Kjo mungesë e mbështetjes institucionale, së bashku me qasjen dhe trajtimin institucional patriarkal dhe të kritikuar të këtyre rasteve, ka shkaktuar dënime nga organizatat dhe aktivistët e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në vitet e fundit, protesta të organizuara janë mbajtur në mbarë Kosovën si përgjigje ndaj dhunës me bazë gjinore dhe femicideve, duke iu referuar veçanërisht numrit alarmues të femicideve.¹

Edhe pse numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara tregon rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore në Kosovë, mungesa e kapaciteteve institucionale për të parandaluar dhunën në bazë gjinore është e evidente. Përveç më tepër, rastet e raportuara shpesh shoqërohen nga një qasje fajësuese për viktimat, e rrënjosur thellë në mendësinë patriarkale të shoqërisë. Serioziteti i kësaj situatë intensifikohet kur merret parasysh shkalla e ulët e punësimit të grave dhe pavarësia e kufizuar financiare e tyre.²

1 "Shqetësimet lidhur me Sigurinë e Grave në Kosovë", Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, <https://qkss.org/en/publikimet/shqetesimet-lidhur-me-sigurine-e-grave-ne-kosove> (e qasshme me 25.6.2024.)

2 Ibid.

GJENDJA AKTUALE E RAPORTIMIT NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE

Në përgjithësi, numri i rasteve të raportuara të dhunës në bazë gjinore në Kosovë është rritur pak ose ka mbetur i njëjtë gjatë viteve të fundit. Ka disa arsye pse është kështu. Shumë vajza dhe gra nuk dinë se ku duhet të drejtohen për mbrojtje, mirëkuptim dhe më në fund edhe për ndihmë. Së dyti, shumë gra nuk u besojnë institucioneve sepse proceset gjyqësore për dhunën në familje zgjasin me vite dhe dhunuesit shpesh marrin dënime shumë të shkurtra, nëse ka fare.

Përfaqësuesja e Qendrës Gjithëpërfshirëse të Grave tha se shkalla e ankesave të rasteve recidive është e lartë. Shumë gra nga komuniteti serb pajtohen me burrat e tyre menjëherë pas ankesës së parë, para se ajo të arrijë në gjykatë. Kjo ndodh kryesisht për shkak të presionit nga familja, por edhe vetë gratë janë të vetëdijshme se dhunuesit e tyre njihen me zyrtarët e policisë lokale, punonjësit socialë etj.³

Gratë në përgjithësi janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre, por nuk dinë se kujt t'i drejtohen në rast nevojë. Sot ka kaq shumë debate dhe ngjarje kushtuar të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi, saqë duket pothuajse e pamundur të jesh plotësisht jo në dijeni për të drejtat e tua në komunitet.⁴ Megjithatë, edukimi për të drejtat e grave është vendimtar në luftimin e dhunës me bazë gjinore. Gratë dhe vajzat në komunat me shumicë serbe nuk janë të vetëdijshme se çfarë përfshin dhuna me bazë gjinore.⁵ Ata prirën të raportojnë vetëm disa raste të dhunës fizike në familje.

Gjatë fushatës 16 Ditët e Aktivizmit të vitit të kaluar (nëntor-dhjetor 2023) përfaqësuesi nga Qendra Komunitare e Pakicave në Graçanicë pati një diskutim me vajzat e shkollave të mesme. Shumica prej tyre deklaruan se dhuna në bazë gjinore ndodh në shkollë. Megjithatë, kur përpiqen ta raportojnë dhe të diskutojnë lidhur me çështjen me drejtorin e shkollës ose psikologun, ata i dekurajojnë dhe u thuhet se “e kanë keqkuptuar situatën”, gjë që krijon një narrativë fajësues për viktimat. Vajzat fillojnë të mendojnë se janë ato që paskan bërë veprim të gabuar. MCC (QKP) ka theksuar se kjo është arsyeja pse ne duhet t'i edukojmë vajzat më shumë për të drejtat e tyre. Nëse dikush ju afrohet dhe ju prek fizikisht pa pëlqimin tuaj, duhet të jeni të vetëdijshëm se ju nuk ajo që e keni “kërkuar një gjë të tillë” ose “keqinterpretuar atë veprim” dhe punonjësit e shkollës duhet të kenë më shumë respekt dhe mirëkuptim për vajzat. Në fakt janë ata që kanë nevojë për më shumë trajnim dhe edukim edhe në këtë fushë. Madje disa punonjëse femra kanë mundur të dallojnë rastet e bullizmit ndaj tyre, por nuk kanë hasur në mirëkuptim për marrë mbrojtjen që e kërkonin.⁶

DISPONUESHMËRIA E STREHIMOREVE TË GRAVE: Ekziston një Strehimore e grave për gratë të komunitetit serb në Novobërdë, e hapur në vitin 2020, e cila ofron strehim dhe ndihmë për të gjitha gratë që kërkojnë mbrojtje për dhunën në bazë gjinore. Pas 24 orësh, periudhës së adaptimit, gratë nënshkruajnë një marrëveshje me personelin e strehimores për të shkëmbyer

3 Intervistë me përfaqësuesen e Qendrës Gjithëpërfshirëse të Grave, maj, 2024

4 Intervistë me përfaqësuesen e Strehimores të Novobërdës, maj, 2024

5 Intervistë me përfaqësuesin e Qendrës Komunitare të Pakicave në Graçanicë, maj 2024

6 Ibid.

informacione, por edhe për të respektuar rregullat e Strehimores.⁷ Gratë nga Graçanica, Shtërpca dhe Ranillugu zakonisht kërkojnë ndihmë nga Strehimorja e grave në Novobërdë. Megjithatë, shumica e banorëve të kësaj Strehimore janë femra shqiptare. Në këto komunitete patriarkale, gratë shpesh hezitojnë të raportojnë dhunën psikologjike dhe fizike për shkak të frikës së gjykimit dhe stigmës nga komuniteti lokal.. Përveç kësaj, vajzat e shkollave të mesme në këto zona nuk ishin në dijeni se shkollat e tyre kanë udhëzime për parandalimin e dhunës në bazë gjinore.⁸

Në rajonin verior të Kosovës, në fshatin Zhupq, në rajonin e komunës së Zubin Potokut, ka ekzistuar Strehimorja rajonale e grave, e cila ka funksionuar deri në dorëheqjen e kryetarëve të komunave, në nëntor të vitit 2022. Fillimisht, kjo Strehimore e grave ishte thjesht vetëm një projekt, ku kishte punësuar personat të afërt me autoritetet zyrtare të asaj kohe (para dorëheqjes së kryetarëve të komunave) dhe që përfshinte shpronësimin e ndërtesës nga Kuvendi i Zubin Potokut. Me dorëheqjen e Kryetarit të komunës dhe këtyre zyrtarëve më 7 nëntor 2022, Strehimorja pushoi së funksionuari. Aktualisht po bëhen përpjekje për të gjetur një objekt të ri në një vend tjetër. Edhe pse kohët e fundit ka pasur pak masa edukuese mbi vetëdijësimin për të drejtat e tyre ose disponueshmërinë në Strehimore, gratë ende këto i arrijnë në mënyrë të pavarur. Ato e dinë se në raste urgjente mund të thërrasin policinë, e cila do t'i çojë në Strehimore në jug të Mitrovicës apo të Novobërdës.⁹

REAGIMI I AUTORITETEVE DHE SISTEMIT GJYQËSOR: Sipas të intervistuarve, gjatë dy viteve të fundit, reagimi i autoriteteve ndaj dhunës në bazë gjinore ka qenë përgjithësisht adekuat, me ndërhyrjet e policisë në kohë të dhe mënyrë të duhur. Megjithatë, procedurat gjyqësore kanë qenë dukshëm të ngadalta. Një përfaqësuese nga Qendra Gjithëpërfshirëse e Grave theksoi rëndësinë e pranisë së psikologëve dhe punonjësve socialë kur viktimat raportojnë dhunën, e në veçanti kur përfshihen fëmijët. Prania e tyre ndihmon në parandalimin e riviktimizimit duke minimizuar nevojën që viktimat të rrëfejnë përvojat e tyre traumatike në mënyrë të përsëritur. Megjithatë, ajo vuri në pah një shqetësim të rëndësishëm: qasja fillestare e disa punonjësve socialë është se shpesh përpiqen të pajtojnë viktimën dhe dhunuesin, gjë që shpesh është e suksesshme. Megjithëse sistemi gjyqësor në përgjithësi funksionon në mënyrë efektive, shpesh janë vetë viktimat ato që vendosin të mos ndjekin procedurat ligjore kundër dhunuesit.¹⁰

BARRIERAT KRYESORE PËR RAPORTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË BAZË GJINORE: Bazuar në intervistat e zhvilluara me gjithë përfaqësuesit e komunave serbe, varësia ekonomike nga partneri është identifikuar si barriera më e madhe për gratë. Shumë gra zgjedhën të bëhen amvise pas përfundimit të shkollës së mesme, duke e bërë të vështirë për to t'i shpëtojnë marrëdhënieve abuzive përpos nëse kanë mbështetje nga prindërit ose të afërmit e tjerë, gjë që është e rrallë në Graçanicë dhe fshatrat fqinje.¹¹

Mentaliteti, paragjykimi dhe tradita janë ndër barrierat kryesore, veçanërisht në komunitetet më të vogla. Ka raste kur gratë kanë frikë të shkojnë edhe në evente dhe konferenca kushtuar temës së dhunës në bazë gjinore, duke menduar se mjedisi i tyre do të supozonte menjëherë

7 Intervistë me përfaqësuesen e Qendrës Gjithëpërfshirëse të Grave, maj, 2024

8 Intervistë me përfaqësuesin e Qendrës Komunitare të Pakicave në Graçanicë, maj 2024

9 Intervistë me përfaqësuesin e Komunës së Mitrovicës së Veriut, maj 2024

10 Intervistë me përfaqësuesen e Qendrës Gjithëpërfshirëse të Grave, maj, 2024

11 Intervistë me përfaqësuesin e Qendrës Komunitare të Pakicave në Graçanicë, maj 2024

se edhe ato janë viktime, pasi puna parandaluese dhe ndërgjegjësuese është thuajse zero. Ka edhe raste kur gratë besojnë se dhuna në familje është një çështje private dhe duhet të zgjidhet brenda familjes.¹²

RËNDËSIA PRAKTIKE E PËRFSHIRJES E MË SHUMË GRAVE NË SEKTORIN E SIGURISË

Besohet se rritja e përfshirjes së grave në sektorin e sigurisë mund të rrisë besimin e grave në kërkimin e zgjidhjeve për problemet e tyre. Një numër më i madh i policeve femra mund të çojë në më shumë raportime rasteve për incidente të tilla; megjithatë, duke qenë se shumica e raportimeve bëhen përmes telefonit, nuk ka asnjë garanci se kush do të reagojë në lidhje me to. Zakonisht, koordinatorët e stacioneve të policisë janë meshkujt, edhe ata marrin vendimet se si të trajtojnë çdo rast ndaras. Edhe pse ka gra që janë të punësuar në polici, prapë numri i tyre duhet të jetë më i lartë. Megjithëse kuotat respektohen, gratë nuk shërbejnë gjithmonë si oficerë të specializuara në rastet e dhunës në familje.¹³ Gratë instinktivisht e ndiejnë se policet femra i kuptojnë më mirë dhe janë më afër ndjeshmërisë. Viktimat me mavijosje në pjesë specifike të ndjeshme të trupit shpesh ndihen më rehat kur flasin me një grua. Megjithatë, bazuar në një intervistë me përfaqësuesen e Qendrës Gjithëpërfshirëse të Grave, ka ende police femra që i gjykojnë viktimat se pse janë kthyer te dhunuesi i tyre kur vijnë për të raportuar të njëjtin burrë për herë të dytë ose të tretë.¹⁴

INTERESI I VAJZAVE PËR TË IU BASHKANGJITUR AKADEMISË POLICORE

Ka interesim të madh nga vajzat në komunat serbe për të aplikuar në Akademinë e Policisë. Edhe pse ka shumë më pak vajza se sa djem, shumë nga ato arrijnë të ndjekin akademisë dhe të punojnë si zyrtare policore.¹⁵ Çështja kryesore është numri i kufizuar i vendeve të disponueshme për vajzat, kështu që jo të gjithë ato që aplikojnë edhe pranojnë. Megjithatë, çdo gjeneratë përfshinë edhe disa vajza nga komuniteti serb.

Në komunitetet më të vogla, vajzat janë më të prirura për të ndjekur studimet në mësimdhënie ose mjekësi pas përfundimit të shkollës së mesme, dhe më rrallë në polici dhe institucionet e sigurisë, përveç nëse kanë mbështetje të fortë familjare. Edhe kur zgjedhin karriera në polici dhe institucione sigurie, ato shpesh preferojnë punën në zyrë sesa punën në terren.

12 Ibid.

13 Intervistë me përfaqësuesen e Qendrës Gjithëpërfshirëse të Grave, maj, 2024

14 Ibid.

15 Intervistë me përfaqësuesin e Komunës së Shtërpocës, maj 2024

REKOMANDIMET

- 1.** Të vazhdohet me përpjekjet për të identifikuar dhe parandaluar dhunën në bazë gjinore duke siguruar burime për fuqizimin ekonomik të grave që do të largohen nga Strehimoret pas një periudhe të caktuar.

- 2.** Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për Strehimoret dhe punëtorët e kualifikuar që flasin serbisht.

- 3.** Organizimi fushatave për të edukuar gratë dhe vajzat nga komunitetet rurale për llojet e dhunës dhe shërbimet e disponueshme në gjuhën e tyre amtare, qoftë brenda komunitetit të tyre ose në qytetin më të afërt më të madh.

- 4.** Rritja e kuotës për numrin e vajzave që mund të regjistrohen në Akademinë e Policisë kur ka interesim më të madh.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

342.742-055.2(=81:496.51)(047)

Živić, Milica

Challenges and Institutional Responses to the Safety of Kosovo Serbian
Women / Milica Živić. – Prishtinë : QKSS, 2024. – 7 f. ; 26 cm.

ISBN 978-9951-842-35-8

RRETH QKSS

E themeluar në prill 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë e specializuar, e pavarur dhe joqeveritare. Qëllimi kryesor i QKSS është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën kërkimore dhe avokuese në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë (SSR) duke mbështetur programet e RSS nëpërmjet hulumtimeve, ngjarjeve, trajnimeve, avokimeve dhe këshillave të drejtpërdrejta të politikës.

Çdo vit, QKSS publikon një numër të madh të raporteve, dokumente të politikave dhe dokumente të shkurtra të politikave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. Gjithashtu, organizon më shumë se 200 evente publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta, debate dhe ligjërata në Kosovë, dhe në bashkëpunim me partnerët regjional dhe ndërkombëtar.

Një gamë e gjerë aktivitetesh përfshin kërkimin, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin. Puna e QKSS-së mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë por pa u kufizuar në reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar, politikën e jashtme dhe bashkëpunimi rajonal, si dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Këtë vit QKSS-ja festoi 16 vjetorin e themelimit. Për më shumë informacion rreth QKSS, ju lutem na vizitoni dhe ndiqni faqet tona në rrjetet sociale:



www.qkss.org

www.securitybarometer.qkss.org



@KCSSQKSS

ISBN 978-9951-842-35-8



9 789951 842358